



**Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina**

**RR E G U L L O R E
PËR
PËRBËRJEN DHE KOMPETENCAT E KOMITETEVE**

Prishtinë, 2010

Në pajtim me dispozitat e nenit 51 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), dispozitat e nenit 42 dhe 33 pika 33.1, shkronja a të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010 dhe Vendimit për themelimin e komiteteve të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 182, të dt. 28.1.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 20.5.2010, miratoi

R R E G U L L O R E N PËR PËRBËRJEN DHE KOMPETENCAT E KOMITETEVE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi i zbatimit

Neni 1

Themelimi i dy (2) komiteteve të përhershme:

- a) Komiteti për Politikë dhe Financa dhe
- b) Komiteti për Komunitete

Caktimi i gjashtë (6) komiteteve të tjera:

- a) Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
- b) Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport;
- c) Komiteti për Zhvillim Ekonomik dhe Rural;
- d) Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit;
- e) Komiteti për Shërbime Publike dhe
- f) Komiteti për Pronë.

Përbërja dhe kompetencat e komiteteve sipas kësaj Rregulloreje

Përkufizimi dhe karakteristikat e përbashkëta

Neni 2

2.1 Përkufizimi

Komitetet janë trupa ndihmëse të Kuvendit të Komunës, të cilat punojnë për Kuvendin dhe në emër të Kuvendit. Roli i tyre është që ta lehtësojnë punën e Kuvendit të Komunës

në lidhje me procesin e marrjes së vendimeve, pasi që Kuvendi nuk është në gjendje që, në tërësi dhe në mënyrë adekuate, të merret me numrin e madh të çështjeve që mund të parashtrihen në Komunë. Shumë çështje me të cilat përballet Komuna, janë të një natyre teknike, që kërkojnë angazhimin e ekspertëve, të cilët mund të mos jenë anëtarë të Kuvendit, por që shërbejnë si anëtarë të komiteteve përkatëse.

Komitetet e lehtësojnë punën e Kuvendit, duke e racionalizuar kohën e marrjes së vendimeve, për t'u ofruar Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit, analiza profesionale, konsultime dhe angazhim për çështjet specifike.

Themelimi i komiteteve tjera bëhet në harmoni me nevojat e Komunës së Prishtinës që i përcakton Kuvendi i Komunës. Komitetet jo të përhershme mbajnë mbledhje një herë në muaj, por, në rast nevoje, mund të mbajnë edhe më shumë. Këto Komitete janë të karakterit këshilldhënës, pa të drejtë në vendimmarrje.

Në mbledhjen e parë, secili komitet cakton orarin e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta gjatë vitit. Mbledhjet e jashtëzakonshme mund të thirren në çdo kohë.

2.2 Karakteristikat e përbashkëta

Shumica e anëtarëve të komiteteve janë anëtarë të Kuvendit të Komunës. Anëtarësia e secilit komitet do të reflektojë, sa më shumë që është e mundur, me proporcionin e vendeve që kanë partitë politike dhe koalicionet në Kuvendin e Komunës. Emërimi i anëtarëve të disa komiteteve do t'i përgjigjet specifikimit të tyre, siç është rasti me disa komitete të përhershme.

II. DISPOZITAT E VEÇANTA

Komitetet e përhershme dhe komitetet tjera

Neni 3

3.1. Komitetet njoftohen rregullisht për aktivitetet e drejtorive përkatëse dhe të ndërmarrjeve publike lokale, si dhe për propozimvendimet dhe raportet tjera periodike që përgatiten për shqyrtim dhe miratim nga Kuvendi.

3.2. Komitetet shqyrtojnë dhe mund të propozojnë modifikimin e programeve kapitale të shpenzimeve, duke propozuar shtimin, heqjen apo modifikimin e projekteve që i dërgohen për shqyrtim Komitetit për Politikë dhe Financa.

3.3. Komitetet shqyrtojnë përgatitjen dhe hartimin e propozimvendimeve që i prezantohen Kuvendit të Komunës për miratim, të cilat i referohen një fushe të caktuar të aktiviteteve brenda përgjegjësisë të komitetit.

Neni 4

4.1. Kryesuesi i Komitetit është përgjegjës për koordinimin e punës së Komitetit dhe përgatit orarin e mbledhjeve, udhëheq listën e pjesëmarrësve, siguron procedurat e kompensimit të anëtarëve të Komitetit, jep informata mbi vlerësimin individual të kryerjes së punëve nga anëtarët dhe i paraqet raport Kuvendit për punën e Komitetit.

4.2. Komiteti e ka të drejtën e bashkëpunimit me organet e Administratës, institucionet arsimore dhe shëndetësore të Komunës dhe ministritë relevante.

4.3. Drejtoria e Administratës ofron mbështetje të nevojshme logjistike dhe administrative për sigurimin e kushteve të nevojshme për mbajtjen e mbledhjeve të komiteteve, duke përfshirë: shpërndarjen e materialeve për mbledhje, vendtakimet, procesmbajtësin, vendosjen e procesverbaleve në dosje dhe të materialeve të tjera të komiteteve.

1. Komitetet e përhershme

Neni 5

a) Komiteti për Politikë dhe Financa

Përbërja

5.1. Komiteti për Politikë dhe Financa përbëhet nga 9 anëtarë të Kuvendit. Kryetarët e komiteteve të tjera të Kuvendit mundë të marrin pjesë në mbledhje nëse kanë material për ta prezantuar.

5.2. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës është kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa. Së paku një anëtar i Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të jetë përfaqësues i minoritarëve.

Kompetencat:

1. Shqyrton draftbuxhetin e propozuar nga Kryetari i Komunës;
2. Shqyrton programet zhvillimore të Komunës;
3. Shqyrton format e organizimit të të hyrave në buxhet;
4. Shqyrton, propozon dhe vlerëson programet investive dhe të shpenzimeve të buxhetit;
5. Shqyrton dhe vendos për ndihma të menjëhershme, të cilat i kalojnë autorizimet e Kryetarit të Komunës, dhe për këtë e njofton Kuvendin;
6. Shqyrton çështjet themelore ekonomike dhe sociale të Komunës, si dhe çështjet me rëndësi të veçantë;
7. Jep mbështetje për zhvillimin ekonomik brenda Komunës, duke përfshirë strukturimin ekonomik;
8. Këshillon Kuvendin, në mënyrë të përgjithshme, në lidhje me zbatimin e procedurave financiare dhe ekonomike;
9. Ushtron të gjitha funksionet e Kuvendit të Komunës, në raste emergjente, të cilat përcaktohen nga Kryetari i Komunës, përpos atyre që nuk delegohen;
10. Propozon shlyerjen e borxheve;
11. Komiteti, në çdo tremujor, i përcjell Kuvendit të Komunës raport mbi gjendjen financiare të Komunës.

b). Komiteti për Komunitete

Përbërja

Komiteti ka nëntë (9) anëtarë, nga të cilët :

- **një rom**, i cili është përfaqësues i komunitetit, por jo anëtar i Kuvendit të Komunës;
- **një turk**, i cili është përfaqësues i komunitetit, por jo anëtar i Kuvendit të Komunës;
- **një ashkali**, i cili është përfaqësues i komunitetit, por jo anëtar i Kuvendit të Komunës;
- **një boshnjak**, i cili është përfaqësues i komunitetit, por jo anëtar i Kuvendit të Komunës;
- **dy serbë**, së paku njëri prej tyre duhet të jetë përfaqësues i komunitetit, por jo anëtar i Kuvendit të Komunës. Së paku një anëtarë i Komitetit për Komunitete duhet të jetë anëtar i Kuvendit të Komunës;
- **tre shqiptarë**, së paku njëri prej tyre duhet të mos jetë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

Anëtarët e Komitetit për Komunitete nga radhët e anëtarëve të Kuvendit dhe jashtë tij, emërohen nga Kuvendi i Komunës.

Kompetencat

Në pajtueshmëri me LVL - në dhe Statutin e Komunës, Komiteti për Komunitete përpiket që, brenda territorit të komunës, të sigurojë se Komiteti për Komunitete është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim, dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve, për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon Kuvendit të Komunës, masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve, për të avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës dhe ushtron edhe përgjegjësi tjera, nëse nuk është rregulluar ndryshe me LVL-në dhe me Statutin e Komunës.

2. Komitetet tjera

Neni 6

a) Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Përbërja

Komiteti përbëhet nga 9 anëtarë, së paku 6 prej tyre duhet të jenë anëtarë të Kuvendit të Komunës, 2 prej tyre të jenë përfaqësues nga pakicat dhe së paku 3 prej tyre të jenë femra.

Kompetencat

Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është përgjegjës për fushat që lidhen me kujdesin parësor dhe në kuadër të bashkëpunimit dhe të kujdesit shëndetësor.

1. Shqyrton draftbuxhetin për Sektorin e shëndetësisë dhe ia dorëzon atë Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit për miratim;
2. Shqyrton dhe jep propozime dhe sugjerime për Projektplanin vjetor të punës, të përgatitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
3. Shqyrton raportin vjetor, të përgatitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, dhe me propozime, ndryshime ose plotësime ia dërgonë KPF - së dhe Kuvendit për miratim;
4. Shqyrton dhe propozon masa përkatëse për mbështetjen komunale grupeve të varfra të njerëzve (invalidët e luftës, viktimat e dhunës familjare, fëmijët jetimë, të pastrehët, të rikthyerit, pensionistët etj.)
5. Mbështet drejtorinë në ushtrimin e kompetencave dhe detyrave në lidhje me strehimin;
6. Vlerëson propozimet e drejtorisë për strategjitë dhe planet e strehimit, duke përfshirë ndërtimin e shtëpive, renovimin e tyre, si dhe mënyrën e shfrytëzimit të tyre për këto qëllime;
7. Shqyrton programet, në raste emergjente, për strehim të refugjatëve, planet dhe zgjidhjet emergjente për fluksin e refugjatëve dhe rikthimin në vendet e tyre.

b) Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport

Përbërja

Komiteti përbëhet nga nëntë (9) anëtarë, prej të cilëve së paku 7 duhet të jenë anëtarë të Kuvendit, 2 prej tyre duhet të jenë përfaqësues të pakicave dhe, së paku 2 prej tyre duhet të jenë të gjinisë femërore.

Kompetencat

Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport është përgjegjës për fushat që kanë të bëjnë me edukimin parashkollor, arsimin fillor, të mesëm të ulët, si dhe arsimin e mesëm të lartë, kopshtet e fëmijëve, kulturën, rininë dhe sportin.

1. Ndihmon Drejtorinë në hartimin e rregulloreve komunale, në pajtim me ligjet në fuqi për arsim, kulturë, rini dhe sport;
2. Shqyrton ankesat dhe propozimet e nxënësve në lidhje me cilësinë e mësimin dhe masat disiplinore;
3. Mbështet bashkëpunimin shkollë - kulturë - shoqëri, në mes të institucioneve arsimore, kulturore dhe shoqërisë përreth, me institucionet publike dhe private që merren me arsimimin e personave dhe institucionet në fushën e kulturës;

4. Ndhomon në planifikimin dhe vlerësimin e nevojave arsimore, kulturore, rinore dhe sportive të Komunës;
5. Shqyrton propozimet dhe inicion planet lokale arsimore, kulturore, rinore dhe sportive;
6. Propozon programet dhe projektet për autoritetet qendrore dhe drejtoritë që kanë të bëjnë me punën e këtij Kuvendi;
7. Mbështet bashkëpunimin shkollë – prindër, bashkëpunimin në mes të shkollave, komunitetit;
8. Mbështet kremtimin e festave shtetërore, lokale dhe ndërkombëtare (Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve, Dita e Muzikës etj.);
9. Shqyrton programet dhe projektet, të cilat subvencionohen nga Komuna dhe propozon mbështetjen e tyre eventuale;
10. Përcjell zhvillimet ndërkombëtare që bëhen në lëmin e kulturës, rinisë dhe sportit që janë me interes për komunën;
11. Përkujdeset që trashëgimisë kulturore dhe historike të qytetit t'i kushtohet rëndësi e veçantë;
12. Shqyrton prioritetet e programeve komunale në sferën e arsimit, kulturës, të rinisë dhe të sportit;
13. Shqyrton programet komunale për investimeve kapitale në arsim, kulturë dhe sport, në mënyrë që t'u ofrojë institucioneve kushtet e nevojshme.

c) Komiteti për Zhvillim Ekonomik dhe Rural

Përbërja

Komiteti përbëhet nga nëntë (9) anëtarë, prej të cilëve së paku shtatë duhet të jenë anëtarë të Kuvendit, dy prej tyre duhet të jenë përfaqësues të pakicave dhe, së paku dy prej tyre duhet të jenë të gjinisë femërore.

Kompetencat

Komiteti për Zhvillim Ekonomik dhe Rural, është përgjegjës për:

1. përkrahjen e programeve të zhvillimit ekonomik të komunës, përfshirë këtu organizimin e panairove të tregtisë dhe tregjeve, inkurajimin e biznesit dhe zhvillimin e turizmit, bashkëpunimin me bizneset lokale apo të përfaqësuara në nivel lokal;
2. inicimin e programeve dhe projekteve zhvillimore ekonomike për zonat urbane dhe rurale;
3. shqyrtimin dhe propozimin e masave për sigurimin dhe mbrojtjen e pyjeve;
4. shqyrtimin dhe propozimin e masave për zhvillimin e bujqësisë;
5. shqyrtimin dhe propozimin e masave për zhvillimin ekonomik dhe të infrastrukturës në zonat industriale dhe në zonat e veçanta rurale;
6. mbështetjen e rindërtimit të pjesëve të qytetit dhe të fshatrave dhe
7. shqyrtimin e programeve të zhvillimit ekonomik në përgjithësi.

d) Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit

Përbërja

Komiteti përbëhet nga 9 anëtarë, prej të cilëve së paku 4 duhet të jenë anëtarë të Kuvendit, së paku 2 prej tyre duhet të jenë përfaqësues të pakicave dhe të jenë së paku 2 femra.

Kompetencat

1. Shqyrton propozimvendimin për qasje në hartimin e planeve urbanistike, propozimvendimet për miratim të projektplaneve urbanistike dhe atyre për miratim të këtyre planeve;
2. Shqyrton propozimet e Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për prioritet dhe strategjitë e nxjerrjes, ndryshimit plotësimit dhe implementimit të planit zhvillimor komunal, urban dhe planeve rregulluese;
3. Shqyrton propozimplanet e punës dhe raportet e punës të Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, para prezantimit të tyre për miratim nga Kuvendi i Komunës;
4. Shqyrton dhe inicion propozime për sigurimin e informatave të nevojshme lidhur me zhvillimet e ndërtimeve ilegale dhe marrjen e masave për parandalimin e tyre;
5. Inicion dhe propozon masa për mbrojtjen e ambientit, me qëllim të parandalimit të ndotjes së mjedisit, si dhe të zbatimit të ligjit dhe akteve tjera nënligjore nga ky lëmë;
6. Shqyrton informatat mbi zbatimin e rregullave të ndërtimit dhe kontrollin e standardeve të ndërtimit, dhe propozon masa për zbatimin dhe kontrollin e tyre;
7. Përkujdeset dhe propozon masa për ruajtjen e objekteve të shpallura me interes arkitektonik apo historik;
8. Shqyrton azhurnimet dhe ndërrimet e paluajtshmërive në evidencat përkatëse të kadastrave, brenda afateve të përcaktuara ligjore sipas bazave juridike të prezantuara nga kërkuesit;
9. Shqyrton çështjet që kanë të bëjnë me evidencimin dhe mirëmbajtjen e regjistrave të pronave të Komunës.

e) Komiteti për Shërbime Publike

Përbërja

Komiteti përbëhet nga 9 anëtarë, së paku 4 prej tyre duhet të jenë anëtarë të Kuvendit, së paku 2 prej tyre duhet të jenë përfaqësues të pakicave dhe 3 anëtarë duhet të jenë të gjinisë femërore.

Kompetencat

1. Këshillon dhe konsultohet me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale;
2. Shqyrton Planin dhe raportin e punës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale;
3. Përcjell zhvillimin dhe zbatimin e planeve dhe vijëveprimeve në lidhje me shfrytëzimin e shërbimeve dhe veprimeve;
4. Shqyrton propozimet për bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve që kryejnë shërbime komunale;
5. Monitoron dhe vlerëson efikasitetin e metodave dhe procedurave për ofrimin e shërbimeve; cakton burimet në përputhje me rrethanat;
6. Shqyrton programet e ofrimit të shërbimeve me ujë dhe projektet për menaxhimin e ujërave të zeza;
7. Shqyrton buxhetin e propozuar vjetor për shërbime, parashikimet e fondeve të nevojshme për personel, mallra dhe shërbime dhe investime;
8. Shqyrton raportet për Kuvendin e Komunës për sistemet operative dhe përmirësimet;
9. Këshillon dhe konsultohet në lidhje me çështjen e mbledhjes së kuotave në arkëtim në të gjitha ndërmarrjet shërbyese;
10. Shqyrton çështjet që kanë të bëjnë me transportin publik dhe propozimet strategjike për rrugë lokale;
11. Shqyrton programet për ndërtimin dhe rindërtimin e infrastrukturës;
12. Shqyrton realizimin e projekteve të infrastrukturës;
13. Shqyrton kërkesat e komuniteteve për ndërtimin e infrastrukturës;
14. Monitoron realizimin e programeve për parqet, fushat rekreative dhe të argëtimit, shëtitoret publike, hapësirat publike të Komunës etj.

f) Komiteti për Pronë

Përbërja

Komiteti përbëhet nga 9 anëtarë, prej të cilëve së paku 4 duhet të jenë anëtarë të Kuvendit dhe së paku 1 prej tyre duhet të jetë përfaqësues i pakicave.

Kompetencat:

1. Mbështet zhvillimin e ardhshëm të komunës, posaçërisht në lidhje me ruajtjen dhe shfrytëzimin racional të pronës – paluajtshmërisë komunale;
2. Shqyrton dhe jep propozime për dhënien në shfrytëzim të pronësisë komunale, para miratimit të tyre nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës;
3. Shqyrton dhe jep propozime për shpalljen e interesit të përgjithshëm të paluajtshmërive në pronësi private, për të cilat destinohet realizimi i përmbajtjeve të caktuara të objekteve me interes të përgjithshëm;

4. Shqyrton dhe jep propozime për marrjen e masave për ruajtjen dhe kthimin e pronave komunale;
5. Shqyrton dhe jep propozime për dhënien e tokës në pronësi komunale në shfrytëzim për ndërtime të objekteve të interesit të përgjithshëm;
6. Përcjell dhe përpunon zbatimin e legjislacionit që rregullon sferën e pronësisë në Kosovë, gjegjësisht në Komunë;
7. Trajton çështjen e uzurpimeve arbitrare të pronësisë komunale dhe propozon masa për kthimin e asaj prone dhe masat tjera ligjore ndaj uzurpuesve;
8. Në bashkëpunim me Komitetin për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, përkujdeset për mbajtjen e evidencave të pronës komunale, ruajtjen e regjistrave të tyre dhe transaksionet eventuale të kësaj prone.

III. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Hyrja në fuqi

Neni 6

6.1 Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për përbërjen dhe kompetencat e komiteteve 01. nr. 110 - 1011, e miratuar më 16.7.2008 nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

6.2 Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Kuvendi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr. 110 --1200, më 16.06.2010

KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS
Sami Hamiti, ecc.i dipl.